



# RAPORTI VJETOR

## INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS





## Misioni i IPK-së

---

**M**isioni i Inspektoratit Policor të Kosovës është që përmes ushtrimit të veprimtarisë së tij, të sigurojë një shërbim policor të përgjegjshëm, demokratik dhe transparent, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e kërkuara.

# Parimet e IPK-së

---

1. Punonjësit e IPK-së duhet të respektojnë Kodin e Etikës të IPK-së dhe parimet që parashihen me Kodin e Mirësjelljes për Nëpunësit Civil.
2. Punonjësit e IPK-së, në përmbushje të detyrave të tyre, do të respektojnë ligjin në fuqi, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe kontribuojnë në realizimin e tyre.
3. IPK udhëhiqet nga parimet e profesionalizmit, objektivitetit, paanshmërisë politike dhe mos diskriminimit.
4. IPK do të reflektojë përbërjen multietnike të Republikës së Kosovës së bashku me parimet e barazisë gjinore dhe të drejtat e njeriut të garantuara më Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
5. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë, IPK është e pavarur.
6. IPK, gjatë hetimit, në pajtim me ligjin e aplikueshëm, është e autorizuar të mbledhë informacione dhe dëshmi, për të përcaktuar sjelljen e punonjësit të Policisë, për të cilin është iniciuar rasti.
7. IPK, duhet t'i zhvillojnë hetimet e tyre në mënyrë të saktë dhe të shpejtë, me qëllim të rritjes së besimit në sundimin e ligjit.
8. Hetuesit e IPK-së autorizimet e tyre i ushtrojnë në pajtim me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale.
9. Procedurat dhe marrja e vendimeve nga IPK, duhet të jetë e hapur dhe transparente, përveç nëse kjo do të rrezikojë apo pengojë rrjedhën e hetimeve.
10. IPK pranon dhe regjistron çdo ankesë të paraqitur nga qytetarët.



## PËRMBAJTJA

I. FJALA HYRËSE E MINISTRIT	6
II.FJALA HYRËSE E KRYESHEFIT EKZEKUTIV	8
III. HYRJE	9
IV. SFIDAT KRYESORE TË IPK-së GJATË VITIT 2012	11
V. AKTIVITETET KRYESORE TË IPK-së NË PRANIMIN E ANKESAVE DHE HETIMIN E RASTEVE GJATË VITIT 2012	13
VI. AKTIVITETET KRYESORE TË IPK-së NË ZBATIMIN E KOMPETENCAVE INSPEKTUESE GJATË VITIT 2012	26
VII. AKTIVITETET KRYESORE TË IPK-së NË MBËSHTETJEN ADMINISTRATIVE DHE LOGJISTIKE TË FUNKSIONEVE TE IPK-së GJATË VITIT 2012	32
VIII. ZHVILLIMI I BASHKËPUNIMIT ME QYTETARËT, ORGANIZATAT VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE	37
IX. PËRFUNDIME	44

# FJALA HYRËSE E MINISTRIT



Bajram Rexhepi  
Ministër i Punëve të Brendshme

**M**inistria e Punëve të Brendshme ka për mision të kujdeset për sundimin e ligjit dhe sigurinë publike në tërë territorin e Republikës së Kosovës, përmes aplikimit të një qasje moderne, profesionale, transparente dhe respektimit të drejtave të njeriut. Këto synime, Ministria e Punëve të Brendshme synon t'i arrin me qëllim të përmirësimit të jetës së qytetarëve, luftimit të krimit dhe dukurive negative, ruajtjes së rendit dhe qetësisë publike, si dhe respektimit të të drejtave dhe lirive të secilit individ. Në mënyrë që të sigurohet efikasiteti i mekanizmave të zbatimit të ligjit në kuadër të këtyre objektivave, element shumë i rëndësishëm është edhe mbikëqyrja demokratike e këtyre mekanizmave.

Në këtë kuadër, brenda strukturës së Ministrisë të Punëve të Brendshme funksionon Inspektorati Policor i Kosovës, që ka për qëllim të siguroj llogaridhënie, efektivitet dhe efikasitet në zbatueshmërinë e ligjeve, akteve nënligjore dhe procedurave standarde të operimit në fuqi. Si një mekanizëm mbikëqyrës dhe i pavarur ka mundur ruajtjen e besimit të qytetarëve tek Policia e Kosovës si një organizatë profesionale që bazohet në parimet e ligjshmërisë, transparencës dhe respektimit

të të drejtave dhe lirive të secilit individ. Gjithashtu Inspektorati Policor ka ndikuar që Policia e Kosovës të vazhdojë rrugëtimin e saj në zhvillimin si institucion demokratik duke aplikuar standardet evropiane dhe praktikat më të mira.

Duke pasqyruar misionin dhe objektivat e Inspektoratit, raporti i vitit 2012 paraqet progresin e arritur dhe sfidat nëpër të cilat ka kaluar ky institucion dhe të cilat duhet të adresohen. Gjatë vitit 2012 ka vazhduar funksionalizimi i IPK-së duke ngritur numrin e personelit me 15 hetues shtesë, dhe ka funksionalizuar edhe dy departamente të reja, Departamentin e Testit të Integritetit dhe Departamentin e Pranimit të Ankesave dhe Analizës së Informacionit. Vizibiliteti i IPK-së ka përbërë një nga objektivat kryesore gjatë vitit 2012, me fokus në fitimin e besimit të qytetarëve, duke rezultuar në bashkëpunim më të madh dhe rritje të rasteve të raportuara në IPK. Krahas kapaciteteve njerëzore, rëndësi e veçantë i është kushtuar edhe infrastrukturës fizike përmes ndërtimit të objektit të IPK-së, me synim krijimin e kushteve të përshtatshme për punë dhe ngritje të efikasitetit në zbatimin e detyrave.

Po ashtu në kuadër të zbatimit të mandatit, IPK ka pranuar një numër të madh të ankesave ndaj zyrtarëve policorë në lidhje me shkelje disiplinore të cilat janë proceduar për hetim disiplinor pranë Drejtorisë për Hetime të Brendshme të Policisë së Kosovës. Ndërsa sa i përket rasteve tjera që janë paraqitur, Inspektorati Policor i Kosovës duke i falënderuar një bashkëpunimi të mirë me të gjitha institucionet relevante, përfshirë këtu strukturat menaxhuese të Policisë së Kosovës, Prokurorinë dhe Gjykatat, gjatë vitit 2012 ka arritur që 78% të rasteve të dyshuara me elemente penale t'i hetoj dhe procedoj tutje. Gjithashtu, IPK-ja gjatë vitit 2012 ka vazhduar të kryej inspektime të rregullta lidhur me performancën e Policisë së Kosovës për fusha të caktuara.

Një Inspektorat Policor funksional dhe i përkushtuar për punë vetëm se do të ndikojë në një punë më profesionale të Policisë dhe nuk duhet të shihet si një mekanizëm i dhunës. Ky mekanizëm do të garantojë qytetarët se Policia e Kosovës ushtron kompetencat e saj në përputhje me ligjin dhe standardet më të avancuara ndërkombëtare dhe mbi të gjitha, të garantojë se po respektohen të drejtat

dhe liritë themelore të individit, të parapara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe konventat ndërkombëtare. Së këndejmi ftoj të gjithë qytetarët e vendit të bashkëpunojnë me Inspektoratin Policor të Kosovës, duke shprehur njëkohësisht besimin se bashkërisht do të vazhdojmë me një angazhim të shtuar në drejtim të përmirësimit të performancës së Policisë së Kosovës, në bazë të standardeve dhe praktikave më të avancuara ndërkombëtare duke u ndjekur nga parimet e profesionalizmit, transparencës dhe mos diskriminimit.

Duke përgëzuar për punën dhe angazhimin e zyrtarëve dhe menaxhmentit të Inspektoratit Policor të Kosovës, shfrytëzoj rastin të konfirmoj përkrahjen time të plotë për funksionimin e pavarur të këtij mekanizmi në vazhdimin e sukseseve që janë arritur deri më tani dhe fuqizimin e tij.

Gjithashtu, besoj fuqishëm se Inspektorati Policor i Kosovës nuk do të mund të arrijë këtë nivel të profesionalizmit pa përkrahjen e vazhdueshme të partnerëve ndërkombëtar si ICITAP-i, OSBE-ja, EULEX-i për çka ju jemi mirënjohjes dhe i ftoj më të vazhdojnë mbështetjen në ngritjen dhe fuqizimin e mëtutjeshëm të Inspektoratit Policor të Kosovës.

# FJALA HYRESE E KRYESHEFIT EKZEKUTIV



Fitim Shishani

Kryeshef Ekzekutiv  
Inspektorati Policor i Kosovës

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës kam nderin e veçantë të paraqes për ju raportin vjetor të Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK) për vitin 2012. Raporti ofron informacione të rëndësishme për sfidat, punën dhe aktivitetet e realizuara nga ana e IPK-së, si Agjension i pavarur i zbatimit të ligjit, rezultate konkrete të arritura gjatë këtij viti dhe sfidat tona për të ardhmen për tu përgjigjur sa më mirë kërkesave dhe nevojave të qytetarëve të vendit.

Inspektorati Policor i Kosovës, tani më është Agjension i konsoliduar, tërësisht i pavarur nga Policia, shumë i besuar nga qytetarët e vendit të cilët edhe këtë vit kanë vazhduar që ti shfrytëzojnë mekanizmat dhe kapacitetet e IPK-së për ti realizuar të drejtat e tyre dhe për të kontribuar për të ndërtuar së bashku një polici të përgjegjshme dhe demokratike të cilën edhe e meritojnë qytetarët e Kosovës.

Inspektorati Policor i Kosovës ka për qëllim parësor, ta ndihmoj Policinë e Kosovës që ta përmbush misionin e saj ligjor, në harmoni me ligjet në fuqi dhe standardet e kërkuara, dhe t'ju ofroj qytetarëve një polici të përgjegjshme,

profesionale dhe efektive.

Lufta kundër korrupsionit në radhët e policisë të jetë prioriteti ynë i përhershëm dhe kryesor duke u kujdesur që askush në Policinë e Kosovës të mos jetë imun ndaj shkeljeve të mundshme ligjore.

Inspektorati Policor i Kosovës, do të vazhdojë të ketë bashkëpunim të ngushtë edhe me organizatat tjera vendore e ndërkombëtare që zbatojnë ligjin në Kosovë. Ne falënderojmë ICITAP-in, OSBE-në, EULEX-in etj, për rolin e tyre në rritjen e performancës dhe trajnimet e ofruara nga ekspertët e tyre.

Inspektorati Policor i Kosovës do të vazhdojë të punoj në vazhdimësi që ne të meritojmë besimin e qytetarëve, duke qenë të vendosur për ta hetuar çdo ankesë që na drejtohet për çdo shkelje të kryer nga punonjësit e policisë, për të cilën ne kemi kompetencë.

Ne falënderojmë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilët kanë bashkëpunuar dhe ndihmuar IPK-në në realizimin e synimeve të parapara me ligj. Ne i sigurojmë qytetarët se në vazhdimësi do të kujdesemi që ti përmirësojmë shërbimet tona ndaj qytetarëve të vendit me qëllim të rritjes së besimit në sundimin e ligjit.



# HYRJE

---

Ky është raporti përmbledhës i punës së Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK) për periudhën Janar – Dhjetor 2012 i cili përmban aktivitete dhe të arritura të dokumentuara konform sistemit të menaxhimit përmes objektivave.

Ky raport prezanton sfidat dhe aktivitetet e ndërmarra nga IPK-ja, bazuar në kompetencat e parapara me legjislacionin në fuqi, të arriturat kryesore gjatë kësaj periudhe, vështirësitë në arritjen e objektivave strategjike dhe sfidat që e presin organizatën në periudhën në vazhdim.

Në këtë raport prezantohet mandati, misioni dhe forma e organizimit të IPK-së për të vazhduar me pjesët tjera të këtij raporti vjetor ku përmbledhen sfidat kryesore gjatë vitit 2012 me të cilat është ballafaquar IPK-ja, duke u përqendruar në qëllimet strategjike të dala nga Plani Strategjik 2012-2015 dhe vazhdon me aktivitetet e IPK-së në zbatimin e mandateve ligjore dhe objektivave strategjike në realizimin me sukses të funksioneve operative (hetuese dhe inspektuese) si dhe funksioneve mbështetëse administrative, të cilat përkrahin dhe ndihmojnë në aspektin logjistik dhe financiar që IPK-ja me sukses të realizojë detyrat e veta operative.

Pjesa e bashkëpunimit me qytetarët, organizatat vendore dhe ndërkombëtare përmban aktivitete konkrete të bashkëpunimit të IPK-së me qytetarët përmes kampanjave të ndryshme të informimit lidhur me të drejtat e tyre, formën dhe mekanizmat e ankimit, bashkëpunimit me organizatat e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare lidhur me


ngritjen e performancës dhe profesionalizmit të IPK-së përmes shkëmbimit të përvojave, trajnimeve, pranimi të këshillimeve dhe mekanizmave tjerë me interes për Inspektoratin Policor të Kosovës.

Pjesa përfundimtare e këtij raporti përmbledh objektivat dhe aktivitetet e vitit 2013 që janë planifikuar të realizohen.

Ky raport, për dallim nga raportet e më hershme ka përmbajtje analitike dhe krahasimore përmes të cilave paraqitet puna e IPK-së në marrëdhënie të drejtpërdrejt në mes të ngarkesës së punës, rezultateve dhe akterve tjerë që ndërlidhen me këto rezultate siç janë Policia e Kosovës, Prokuroria, Gjykatat etj.

Inspektorati Policor i Kosovës aktivitetet i ka zhvilluar përmes departamenteve operative që ushtrojnë funksione hetuese dhe inspektuese që janë: Departamenti i Hetimeve, Departamenti i Inspektiveve, Departamenti i Testit të Integritetit dhe Departamenti për Analizimin e Informacionit dhe Menaxhimin e Ankesave, kurse Departamenti i Administratës dhe Shërbimeve Mbështetëse ushtron aktivitet mbështetës në funksion të departamenteve operative.

Në vitin që lamë pas, IPK-ja edhe pse ka qenë në një proces transformimi, si në aspektin funksional, po ashtu edhe në atë organizativ, ka punuar dhe menaxhuar sipas qëllimeve dhe objektivave të parapara në planin strategjik dhe planin vjetor duke arritur rezultate të qëndrueshme dhe domethënëse.





#### IV. SFIDAT KRYESORE TË IPK-së GJATË VITIT 2012

Mungesa e një planifikimi afatgjatë lidhur me ballafaqimin me sfidat e reja të cilat kishte përpara IPK-ja ishte sfida më e madhe që kishte përpara që nga ndryshimet e fundit ligjore gjatë vitit 2010. Kjo sfidë është tejkaluar me hartimin e Planit Strategjik 2012-2015 përmes të cilit janë identifikuar sfidat kryesore për të cilat janë paraparë disa qëllime dhe objektiva strategjike. Një pjesë e tyre tanimë veç është realizuar me aktivitete dhe rezultate konkrete gjatë vitit të kaluar.



Qëllimi kryesor strategjik të cilin IPK-ja ia kishte parashtruar veti ishte që *“IPK të jetë një lider i njohur kombëtar në zbatimin e mandateve ligjore për të parandaluar keq-menaxhimin, korrupsionin dhe aktivitetet tjera kriminale brenda Policisë së Kosovës”*. Këtë qëllim strategjik, IPK ka planifikuar ta arrijë duke vendosur si objektiv strategjik *“Vendosjen dhe ruajtjen e standardeve profesionale në zbatimin e mandateve ligjore të IPK-së duke parandaluar keq-menaxhimin, korrupsionin dhe aktivitetet tjera kriminale brenda Policisë së Kosovës”*, duke hartuar udhëzime administrative dhe rregullore konkrete që kanë të bëjnë me vendosjen dhe ruajtjen e standardeve profesionale gjatë punës së saj.

#### QËLLIMET STRATEGJIKE TË IPK-SË

- 1. IPK do të jetë një lider i njohur kombëtarë në zbatimin e mandateve ligjore për të parandaluar keq-menaxhimin, korrupsionin dhe aktivitetet tjera kriminale brenda Policisë së Kosovës.*
- 2. Të mbështetet iniciativa e Administratës së IPK-së duke i'u mundësuar individëve që shpejt të hyjnë në fuqinë punëtore të IPK-së*
- 3. Përpjekje efektive e IPK-së gjatë komunikimit në terren për t'iu siguruar qytetarëve dhe palëve të interesuara informacione relevante, në kohë dhe të rifreskuara.*
- 4. IPK-ja është Punëdhënës që përkujdesët, vlerëson dhe zgjedh burimet e saja sipas standardeve më të larta.*
- 5. IPK-ja do të përqendrohet për të siguruar shërbim të shkëlqyer për qytetarët, për akterët-partnerët e saj të jashtëm dhe të brendshëm përmes një shërbimi ndaj konsumatorëve i cili do të jetë i kompletuar, konciz, korrekt, i kujdesshëm, i kryer me përkushtim, i kryer me mirësjellje, dhe i qartë.*
- 6. IPK-ja do të mbajë afër dhe do të shfrytëzojë përparimet e fundit teknologjike për t'i shërbyer më mirë akterëve-partnerëve të saj.*



Zbatimi i mandateve ligjore të IPK-së për të parandaluar keq-menaxhimin, korrupsionin dhe aktivitetet tjera kriminale brenda Policisë së Kosovës ndërlidhet shumë me kapacitetet njerëzore dhe financiare që ka një organizatë. Andaj, IPK-ja gjatë vitit të kaluar ka arritur me sukses të planifikojë dhe të nxjerr një propozim për ndryshimin e buxhetit për të rritur burimet hetimore dhe inspektuese deri në plotësimin e strukturës organizative. Gjatë vitit të kaluar kapacitetet njerëzore dhe financiare janë shtuar dukshëm në IPK, qëllim tjetër ky i IPK-së i realizuar me sukses, i paraparë në Planin Strategjik 2012-2015.

IPK-ja vazhdimisht ka siguruar informacione në lidhje me hetimet dhe inspektimet duke shpërndarë informata për qytetarët dhe grupet e interesit, duke treguar transparencë dhe gatishmëri për të punuar edhe me të tjerët të cilët ndajnë të njëjtin vizion për të pasur një polici të denjë dhe llogaridhënëse ndaj qytetarëve të saj.

IPK-ja ka punuar shumë në zhvillimin e partneriteteve për të promovuar edukimin e përgjithshëm qytetar, ka zhvilluar shumë aktivitete me institucione dhe organizatat profesionale për të shpërndarë informacion për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve përmes paraqitjeve mediale, kampanjave sensibilizuese, spoteve televizive etj.

IPK-ja ka themeluar një *Bord Edukativ* përmes të cilit do të realizojë një fushatë të gjerë të agjencionit për edukim dhe sensibilizim të titulluar *Qytetar merre iniciativën*, k dhe duke bërë një analizë të rezultateve të kampanjave të më hershme sensibilizuese dhe duke bërë modifikimin e fushatave tjera sipas nevojave.

Përqendrimi i IPK-së do të jetë, të sigurojë shërbim të shkëlqyer për qytetarët, për akterët-partnerët e saj të jashtëm dhe të brendshëm përmes një shërbimi ndaj qytetarëve i cili do të jetë – i kompletuar, korrekt, i kujdesshëm, i kryer me përkushtim, me mirësjellje, dhe i qartë.

IPK-ja ka bërë vlerësimin e reagimeve (informatat kthyes) përmes *Ekipit për Përmirësimin e Proceseve* për të përcaktuar realizueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e ndryshimit të praktikave të punës për të përmbushur sa më mirë të priturat e Policisë së Kosovës dhe të priturat e qytetarëve.



IPK do të mbajë afër dhe do të shfrytëzojë përparimet e fundit të teknologjisë informative për t'i shërbyer më mirë qytetarëve të saj. Rifreskimi dhe zgjerimi i sistemit operativ të TI-së lidhur me zbatueshmërinë e mandateve ligjore, pajisjeve dhe softuerit, do të bëjë ridizajnimin e sistemit kompjuterik për përdorim nga departamentet lidhur me zgjidhjen e ankesave, hetimet, dhe disiplinës. IPK-ja do të përmirësoj akoma qendrën e ueb-portalit të IPK-së i cili do të ketë linkun për ankesa të qytetarëve, formën e raportimit ad-hoc, dhe mundësitë për të përmirësuar imazhin dhe nxitjen e përdorimit të mjeteve të mediave sociale (Facebook, Twitter, dhe YouTube).



## V. AKTIVITETET KRYESORE TË IPK-së NË PRANIMIN E ANKESAVE DHE HETIMIN E RASTEVE GJATË VITIT 2012

Bazuar në kompetencat e dala nga ligji për Inspektoratin Policor të Kosovës, IPK-ja është e obliguar që të pranoj të gjitha ankesat e qytetarëve si dhe të shqyrtoj dhe përcaktoj se cila nga ankesat hetohet nga IPK-ja dhe cilat do ti referohen Policisë së Kosovës apo institucioneve tjera përgjegjëse. Sipas këtij ligji, Inspektorati Policor i Kosovës është i obliguar që të hetoj të gjitha rastet ku janë të involvuar punonjësit e Policisë së Kosovës e të cilat raste kanë elemente të veprës penale apo shkelje disiplinore të profilit të lartë ku përfshihen zyrtarët policorë të nivelit të lartë menaxherial dhe ekzekutiv.




Për periudhën janar-dhjetor 2012, IPK-ja ka pranuar gjithsej 1078 ankesa ndaj zyrtarëve policorë në lidhje me shkelje disiplinore dhe penale. Pas analizimit dhe klasifikimit të ankesave, IPK-ja ka proceduar për hetim disiplinor pranë Drejtorisë për Hetime të Brendshme të Policisë së Kosovës 776 raste. Këto raste nuk kanë pasur elemente të veprës penale apo nuk janë kualifikuar si shkelje disiplinore të profilit të lartë siç është e paraparë me Ligjin për IPK-në. Ne kemi hetuar 302 raste të cilat janë kualifikuar si kompetencë e IPK-së për hetim nga të cilat 292 raste kanë qenë raste me elemente të veprës penale ndërsa 10 nga to kanë qenë raste disiplinore të profilit të lartë (*shih tabelën dhe diagramin 1*)

Tabela .1

KLASIFIKIMI DHE PROCEDIMI I RASTEVE PËR HETIME		
PËR HETIME NË IPK		PËR DREJTORINË E HETIMEVE TË BRENDSHME, POLICIA E KOSOVËS
Elemente të Veprës penale	Elemente të Shkeljes disiplinore profilit të lartë	Shkelje disiplinore të profilit të ulët
292	10	776
302		
1.078		



Diagrami 1



Siç shihet edhe nga tabelat e më sipërme nga 1.078 raste të pranuar nga IPK-ja, 72% e tyre janë kategorizuar të profilit të ultë disiplinorë të cilat janë kompetencë e PK-së për hetime të brendshme disiplinore, ndërsa 28% e tyre janë kualifikuar si kompetencë e IPK-së për hetime.

Inspektorati Policor i Kosovës gjatë vitit 2012 ka vazhduar me intensitet mjaft të dendur të pranimit të rasteve të cilat kanë qenë kompetencë për hetime penale dhe disiplinore të profilit të lartë por, dominuese kanë qenë rastet penale.

Gjatë analizave të pranimit të rasteve për hetime është konstatuar se IPK-ja ka pasur një mesatare prej 25 rasteve për muaj, krahasuar me numrin e hetuesve i bie që një hetues ka qenë i ngarkuar me më shumë se një rast në muaj.


Nga ky intensitet i rasteve të pranuar për hetime, një hetues gjatë vitit 2012 ka qenë i ngarkuar me një mesatare prej 17 raste për hetim. Sipas analizave të statistikave të IPK-së, muajt më të ngarkuar me raste gjatë vitit 2012 kanë qenë muajt mars, maj dhe gusht ku numri i rasteve ka arritur shifrën 28-32 raste (*shih tabelën dhe diagramin 2*).



Tabela. 2

NUMRI DHE LLOJI I RASTEVE QË JANË INICUAR PËR HETIME SIPAS MUAJVE													
Statusi apo lloji i rasteve	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali 2012
Hetime disiplinore të profilit të lartë	0	0	4	0	2	0	1	0	0	0	0	3	10
Hetime për vepra penale	24	17	28	27	30	16	24	28	27	27	24	20	292
Total i Hetimeve të inicuar në Departamentin e Hetimeve	24	17	32	27	32	16	25	28	27	27	24	23	302

Diagrami. 2



Gjatë vitit 2012, IPK-ja ka hetuar raste të llojeve dhe natyrave të ndryshme, rastet më të shpeshta me elemente të veprës penale gjatë këtij vitit kanë qenë rastet; lëndimi i lehtë trupor, 52 raste, keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës - 45 raste, shpërdorim i detyrës zyrtare apo autorizimit - 42 raste, rrezikim i trafikut publik - 40 raste etj.

Për dallim nga viti 2011 kur rastet më të shpeshta në kompetencë të IPK-së për të hetuar ishin rastet e rrezikimit të trafikut publik, kanosja dhe keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, këtë vit prijnë rastet e lëndimit të lehtë trupor të përcjell nga keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare dhe shpërdorimi i detyrës zyrtare apo autorizimit (*shih tabelën nr 3*).



Tabela. 3

RASTET MË TË SHPESHTA TË HETUARA NGA IPK-JA		NUMRI I PËRGJITHSHËM
<b>Raste disiplinore të profilit të lartë</b>		
1	Shkelje e rëndë e autorizimit (neni 9 i U/A 15/2008 MPB)	06
2	Përdorim i tepërt i forcës (neni 11 i U/A 15/2008 MPB)	04
<b>Rastet me elemente të veprës penale</b>		
1	Lëndim i lehtë trupor (neni 153 i KPK)	52
2	Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare (neni 164 i KPK-së)	45
3	Shpërdorim i detyrës zyrtare apo autorizimit (neni 339 i KPK-së)	42
4	Rrezikim i trafikut publik (neni 297 i KPK-së)	40
5	Kanosje (neni 161 i KPK-së)	30
6	Marrja e ryshfetit (neni 343 i KPK-së)	10
7	Vjedhje (neni 252 i KPK-së)	10
8	Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm (neni 291 i KPK-së)	9
9	Kontrabandim me mallra (neni 273 i KPK-së)	8
10	Mbajtje në pronësi, kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve (neni 328 i KPK-së)	7
11	Falsifikim i dokumentit zyrtar (neni 348 i KPK-së)	6
12	Dhunë në familje Ligji mbi dhunën në familje (vepër e veçantë e përcaktuar me ligj të veçantë)	5

**Shembull rasti:** Pas pranimit të informacionit nga hetuesi kujdestar i regjionit të Prishtinës, për një zyrtar policor të caktuar në detyrë në ruajtjen e objektit qeveritar në Prishtinë, dyshohet se kishte vjedhur disa kanistra me derivate të naftës, të cilat kanë qenë të dedikuara për gjenerator të objektit. Në vend të ngjarjes menjëherë kishin dalë hetuesit e IPK-së, të cilët kishin zënë në flagrancë zyrtarin policor duke i vendosur kanistrat me derivate të naftës në automjetin e tij. Me urdhëresë të prokurorit i dyshuari është arrestuar dhe është dërguar në qendrën për mbajtje. Pas sigurimit të provave materiale është ushtruar kallëzim penal ndaj të njëjtit polic me dyshimin për veprën penale “Vjedhje e rëndë” dhe “Shpërdorim i detyrës zyrtare apo autorizimit”. Çështja është në Prokurorinë kompetente.





Policia e Kosovës gjatë vitit 2012 ka pasur një personel prej 8395 punonjësve për të cilët, sipas ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës, IPK-ja ka mandat që të pranoj ankesa nga qytetarët dhe të zhvilloj hetime kur këto ankesa kanë elemente të veprës penale apo janë të profilit të lartë disiplinorë. Siç dihet Policia e Kosovës ka një strukturë komplekse organizative me funksione dhe detyra të ndryshme për të cilat kanë nevojë qytetarët e vendit në mënyrë që ata të ndihen të sigurt dhe të realizojnë të drejtat e tyre dhe si e tillë është e ndarë në nënndarje të shumta me detyra dhe përgjegjësi të llojllojshme. Në kuadër të këtij raporti ne do të paraqesim shkeljet disiplinore dhe penale të Policisë së Kosovës të cilat janë në mandatin e IPK-së për tu hetuar sipas njësive bazë - Drejtorive Rajonale dhe Drejtorisë së Përgjithshme - dhe sipas gradave në Policinë e Kosovës (shih tabelën nr. 4).

Tabela. 4

PUNJONJËSIT E POLICISË TË HETUAR NGA IPK-ja										
Gradat	Totali	DRP Prishtinë	DRP Pejë	DRP Mitrovicë	DRP Prizren	DRP Gjilan	DRP Ferizaj	Drejtoria e Përgjithshme	Policia Kufitare	Totali
Polic	Sipas strukturës	918+131pp <sup>1</sup>	616	695	533	452	347	1260	1052	6004
	Të hetuar	78	40	47	31	19	17	14	37	283
Rreshter	Sipas strukturës	101	90	62	106	65	36	182	137	779
	Të hetuar	11	5	2	5	5	4	3	1	36
Toger	Sipas strukturës	32	33	21	23	30	17	92	35	283
	Të hetuar	6	6	1	1	2	0	0	0	16
Kapiten	Sipas strukturës	9	4	6	9	7	3	29	15	82
	Të hetuar	3	0	1	0	1	0	2	0	7
Major	Sipas strukturës	4	1	2	3	1	1	14	5	31
	Të hetuar	0	2	0	1	0	0	0	1	4
N/Kolonel	Sipas strukturës	0	2	2	2	2	0	11	2	21
	Të hetuar	0	0	0	0	0	0	1	0	1
Kolonel	Sipas strukturës	0	2	0	0	1	0	13	3	19
	Të hetuar	0	1	0	0	0	0	1	1	3
Zyrtar policor	Sipas strukturës	1195	748	788	676	558	404	1601	1249	7219
	Të hetuar	98	54	51	38	27	31	21	40	350
Staf Civil	Sipas strukturës	152	104	134	113	89	84	498	47	1176
	Të hetuar	3	1	1	0	0	2	4	0	11
Totali zyrtar policor+ Staf Civil	Sipas strukturës	1347	852	922	789	647	488	2099	1296	8395
	Të hetuar	101	55	52	38	27	23	25	40	361


<sup>1</sup> Polic praktikant



# Raporti vjetor

Siç shihet edhe më lartë, Policia e Kosovës ka në total 8395 punonjës, nga të cilët të uniformuar dhe me grada të ndryshme janë 7219, ndërsa staf civil i pa uniformuar- pa kompetenca policore janë 1176. Gjatë vitit 2012 si subjekt i hetimeve në Inspektoratin Policor të Kosovës kanë qenë 361 punonjës të Policisë së Kosovës pa dallim grade apo pozite. Nëse këtë e kthejmë në përqindje atëherë subjekt i hetimeve në Inspektoratin Policor të Kosovës kanë qenë 4% e punonjësve të Policisë së Kosovës ( shih diagramin nr. 3).

Diagrami. 3



Ligji për Policinë e Kosovës i jep autorizime policore personelit të uniformuar nën betim të PK-së, autorizime të cila e bëjnë policinë e veçantë dhe me veçanti që e dallojnë nga organizatat tjera. Policia e Kosovës siç dihet ka një mision të pa zëvendësueshëm dhe vital për sigurinë e shtetit dhe të qytetarëve të saj dhe si e tillë përgjegjësia e saj është dhe duhet të jetë e nivelit më të lartë.

Subjekt i hetimeve në IPK kanë qenë 5% e stafit të uniformuar nën betim të Policisë së Kosovës pa dallim grade dhe pozite( shih diagramin nr. 4).

Diagrami. 4






Policia e Kosovës ka të graduar një personel prej 1215 oficerëve të cilët menaxhojnë të gjitha vijat e menaxhmentit, nga vija e parë menaxhuese e deri te niveli i lartë drejtues ekzekutiv. Policia e Kosovës ka 779 rreshter, 283 toger, 82 kapiten, 31 majorë, 21 nënkolonelë dhe 19 kolonelë. Inspektorati Policor ka kompetencë që të hetoj të gjithë zyrtarët policor pa dallim grade dhe gjatë vitit 2012 ka hetuar raste nga të gjitha gradat ekzistuese në Policinë e Kosovës.

Gjatë vitit 2012 subjekt i hetimeve në IPK kanë qenë 361 punonjës të Policisë së Kosovës prej tyre 67 zyrtar të graduar apo 22%, prej tyre; 3 kolonel apo 1%, 1 nënkolonel apo 0%, 4 major apo 1%, 7 kapiten apo 2%, 16 toger apo 5%, 36 rreshter apo 10%, 283 zyrtarë policor apo 78% si dhe 11 punonjësve nga stafi civil që përbënte 3% nga totali i punonjësve të PK-së si subjekt i hetimeve nga IPK-ja (shih diagramin nr. 5).

Diagrami. 5



**Shembull rasti:** Një qytetar ka ardhur në IPK dhe ka deklaruar se një rreshter dhe një avokat, i kishin kërkuar një shumë të të hollave (prej 7.000 euro) për t'ia mbyllur një rast i cili ishte duke u hetuar nga po i njëjti rreshter. Pas marrjes së veprimeve hetimore IPK-ja, me autorizim të prokurorit, ka arrestuar rreshterin dhe avokatin nën dyshimin e veprës penale "Shpërdorim i detyrës zyrtare apo autorizimit" dhe "Marrja e ryshfetit". Lidhur me këtë rast IPK-ja ka ngritur kallëzim penal pranë Prokurorisë kompetente.




# Raporti vjetor

Inspektorati Policor i Kosovës përmes statistikave dhe analizave të rasteve të hetuara sipas drejtorive të PK-së ka identifikuar numrin dhe përqindjen e personelit që kanë qenë subjekt i hetimeve nga IPK-ja. Sipas numrit dhe përqindjes kemi këtë renditje; DRP e Prishtinës me 98 apo 28% e punonjësve, DRP i Pejës me 55 apo 15% e punonjësve, DRP i Mitrovicës me 52 apo 14% e punonjësve, pastaj vjen DRP e Prizrenit dhe Policia Kufitare me 38 gjegjësisht 40 punonjës të hetuar apo 11% e punonjësve, e përcjellur nga DRP e Gjilanit me 27 apo 8%,



Drejtoria e Përgjithshme me 25 apo 7% dhe DRP e Ferizajt me 23 apo 6% e punonjësve. ( shih diagramin nr. 6).

Diagrami. 6



**Shembull rasti:** Në bashkëpunim me Njësinë e Hetimeve të Departamentit të Policisë Kufitare (NJHDPK), IPK-ja ka zhvilluar një hetim penal, për veprën penale “Kontrabandim me emigrant”. Gjatë hetimeve janë aplikuar edhe masat e fshehta hetimore, ku përveç një grup personash të dyshuar pjesë e këtij grupi ishte edhe një zyrtar policor me detyrë në Stacionin Policor “Jugu” në Mitrovicë. IPK-ja, me vendim të prokurorisë dhe në bashkëpunim me NJHDPK ka bërë arrestimin e zyrtarit policor dhe pjesëtarëve të tjerë të grupit kriminal. Gjithashtu janë zhvilluar edhe bastisjet në lokacionet e ndryshme, me qëllim të mbledhjes së provave materiale. Lidhur me këtë rast është ushtruar kallëzim penal pranë Prokurorisë. Personat e arrestuar lidhur me këtë rast akoma gjenden në paraburgim dhe çështja është Prokurorinë kompetente.




Inspektorati Policor i Kosovës gjatë punës ka dëshmuar një profesionalizëm të lartë duke trajtuar çdo ankesë me seriozitetin më të madh duke dëshmuar paanësi dhe seriozitet përpara çdo qytetari pa marr parasysh përkatësinë e tij etnike, gjinore, politike apo çfarëdo përkatësie tjetër.

Ankesa lidhur me shkeljet e supozuara nga punonjësit e Policisë së Kosovës kanë ardhur nga të gjitha kategoritë e qytetarëve të Kosovës. Gjatë vitit 2012, Inspektorati Policor i Kosovës, lidhur me shkeljet e supozuara të punonjësve të Policisë së Kosovës me elemente të veprës penale apo shkelje disiplinore të profilit të lartë, ka pranuar ankesa nga 268 qytetarë nga të cilët 250 apo 93% e tyre kanë qenë shqiptar, 12 apo 5% serb, 4 apo 2% nga grupet etnike RAE, 1 ka qenë boshnjak dhe një turk<sup>2</sup>( shih tabelën nr. 5 dhe diagramin nr. 7).

Tabela. 5

PËRKATËSIA ETNIKE E PARASHTRUESVE TË ANKESAVE ME ELEMENTE TË VEPRËS PENALE OSE TË PROFILIT TË LARTË DISIPLINORE	
PËRKATËSIA ETNIKE	NUMRI
SHQIPTAR	250
SERB	12
BOSHNJAKË	1
TURQ	1
RAE	4
GORAN	0
TOTALI	268

Diagrami. 7



<sup>2</sup> Nga 302 raste penale dhe disiplinore të profilit të lartë kanë qenë 268 ankesues, ndërsa rastet tjera kanë qenë sipas detyrës zyrtare apo nga institucionet tjera.



# Raporti vjetor

Nga 1078 ankesa që ka pranuar Inspektorati Policor i Kosovës gjatë vitit 2012, pas analizimit dhe klasifikimit, të këtyre ankesave dhe pas hetimit të bërë për 292 raste me elemente penale, Departamenti i Hetimeve në Prokurorit kompetente me kallëzim penal<sup>3</sup> ka dërguar 122 raste apo 42% të rasteve, ndërsa me raport të veçantë<sup>4</sup> janë dërguar 86 raste 30% e rasteve, në gjykatë për kundërvajtje<sup>5</sup> është proceduar një rast, në bazë të autorizimeve që ka IPK-ja pas hetimit janë mbyllur<sup>6</sup> 18 raste në IPK apo 6% e rasteve, ndërsa 65 raste janë në proces të hetimit<sup>7</sup> të bartura për vitin 2013 apo 22% e rasteve, pra Inspektorati Policor i Kosovës ka arrit që 78% të rasteve me elemente kriminale ti hetoj dhe procedoj tutje( *shih tabelën nr. 6 dhe diagramin 8*).



**Shembull rasti:** Dy zyrtarë policorë të NJTR-Prishtinë në rrugën magjistrale Prishtinë-Pejë e kishin ndaluar një shtetas nga Republika e Maqedonisë, i cili kishte qenë duke udhëtuar me makinën e tij në drejtim të Pejës. Të njëjtit polic i kishin kërkuar para në vlerë prej 50 euro, me qëllim që mos të i'a shqiptojnë një tiketë për kundërvajtje në komunikacion. Shtetasi i Republikës së Maqedonisë i kishte dhënë para në vlerë prej 50 euro dy zyrtarëve policor, por menjëherë rastin e kishte denoncuar në polici. Me të marr informatën IPK-ja me asistim të zyrtarëve policor në Stacionit Policor në Drenas ka arritur që ti arrestojë dy zyrtarët policor të NJTR-së. Me vendim të Prokurorit të dyshuarit janë dërguar në qendrën për mbajtje. Lidhur me këtë rast është ushtruar kallëzim penal ndaj këtyre zyrtarëve policorë për veprën penale “Marrja e ryshfetit”, çështja është dërguar në Prokurorinë

<sup>3</sup> IPK-ja përpilon kallëzim penal në të cilin paraqiten provat e zbuluara në procesin e mbledhjes së të dhënave dhe i dorëzohet prokurorit të shtetit së bashku me sendet, skicat, fotografitë, raportet e marra, procesverbalet e masave dhe veprimeve të kryera, shënimet zyrtare, deklaratimet e marra dhe materialet e tjera të cilat mund të kontribuojnë në zbatimin efektiv të procedurës.

<sup>4</sup> Nëse masat dhe veprimet e kryera nga Inspektorati Policor i Kosovës, provat dhe të dhënat e mbledhura nuk sigurojnë bazë për kallëzim penal dhe nëse kjo nuk justifikon ekzistimin e dyshimit të arsyeshëm se është kryer veprë penale, Inspektorati Policor i Kosovës dërgon për këtë raport të veçantë në prokurori.

<sup>5</sup> Me rastet të cilat janë pranuar në Inspektorat Policor të Kosovës, ku kanë munguar elementet e veprës penale, por për veprën e pahijshme është paraparë ndëshkimi për kryerjen e kundërvajtjes, atëherë pas konsultës me prokurorin, IPK-ja, rastin e procedon në Gjykatën për Kundërvajtje.

<sup>6</sup> Për rastet të cilat është bërë hetimi parapenal dhe pas konsultës me prokurorin kompetent IPK-ja është udhëzuar se në atë rast nuk ka elemente të veprës penale, por vetëm elemente të shkeljes administrative, atëherë a'i rast mbyllet në IPK me një raport të hetuesit dhe rasti procedohet në organet kompetente për hetim administrativ (disiplinor).


<sup>7</sup> Rastet për të cilat Inspektorati Policor i Kosovës ka ngritur kallëzim penal pranë prokurorisë së shtetit dhe ato raste janë duke u trajtuar nga prokuroria e shtetit, deri sa nuk vendoset që prokuroria të ngritë Aktakuzë, Propozim-akuzë, apo ta hedhë poshtë kallëzimin penal të paraqitur nga IPK-ja, konsiderohen raste në proces në prokurorinë e shtetit.



Tabela. 6

STATUSI I RASTEVE TË HETUARA SIPAS MUAJVE													
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersho	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
Kallëzime penale	10	8	14	10	7	12	12	14	12	8	13	2	122
Raporte të veçanta	12	8	13	8	10	2	9	9	6	5	4	0	86
Gjykatë për kundërvajtje	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Rastet të mbyllura në IPK	3	0	4	1	4	1	0	2	2	0	1	0	18
Rastet nën hetim /proces/	0	1	1	2	1	2	7	4	6	14	11	16	65
<b>Totali i statusit të rasteve të hetuara për muaj</b>	<b>26</b>	<b>17</b>	<b>32</b>	<b>21</b>	<b>22</b>	<b>17</b>	<b>28</b>	<b>29</b>	<b>26</b>	<b>27</b>	<b>29</b>	<b>18</b>	<b>292</b>

Diagrami . 8



Nga 122 lëndë që janë proceduar në prokuroritë kompetente me kallëzime penale, për 41 kallëzime penale prokuroria ka ngritur propozim akuzë apo aktakuzë ndaj të dyshuarve dhe rastet janë proceduar për në gjykatat kompetente apo për 34% të rasteve të proceduara në prokurori, për 8 kallëzime penale prokuroritë kompetente i kanë pushuar hetimet në mungesë të fakteve apo 6% të Kallëzimeve penale, ndërsa 73 kallëzime penale të ngritura nga IPK-ja apo 60% të këtyre Kallëzimeve penale janë në proces në prokuroritë kompetente të Republikës së Kosovës (shih tabelën nr. 7 dhe diagramin 9).

Tabela. 7

STATUSI I KALLËZIMEVE PENALE TË PROCEDUARA NË PROKURORITË PUBLIKE	
Kallëzime penale me propozim akuzë apo aktakuzë të ngritur	41
Kallëzime penale të hedhura poshtë	08
Kallëzime penale në proces në Prokurori	73
<b>Totali</b>	<b>122</b>



Diagrami. 9



Për 41 kallëzime penale që është ngritur propozim akuza apo aktakuza nga prokuroria, tre nga këto raste kanë përfunduar në gjykata kompetente, për dy aktakuza është dhënë masa e urdhrit ndëshkimor, ndërsa lidhur me një aktakuzë është dhënë dënimi me 1 vit burg (shih tabelën nr. 8).

Tabela. 8

VENDIMET E GJYKATAVE DHE LLOJET E VENDIMEVE		
VENDIMET E GJYKATAVE	LLOJET E VENDIMEVE	
03	Urdhër ndëshkimor	02
	Dënim me 1 vjet burgim	01

**Shembull rasti:** Pasi IPK-ja kishte ardhur në dijeni, se në dhomën e dëshmisë së Drejtorisë Rajonale të Policisë në Pejë mungonte një sasi e arit, e cila ka qenë duke u ruajtur dhe në përgjegjësi të zyrtarëve policorë të këtij regjioni. Për të hetuar këtë rast menjëherë janë angazhuar një grup i hetuesve të IPK-së me qëllim të zbardhjes së këtij rasti. Pas marrjes së disa veprimeve hetimore janë identifikuar përgjegjësit e dhomës së dëshmisë, si dhe personat e dyshuar për mungesën e arit. Me urdhër të Prokurorit janë arrestuar katër zyrtarë policor nga DRP-Pejë dhe ndaj tyre është ngritur kallëzim penal me dyshimin e bazuar për veprën penale “Krim i organizuar dhe “Përvetësim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare.

Në vazhden e hetimeve, përmes metodave të ndryshme hetimore, IPK-ja ka ardhur edhe deri te informacioni se i implikuar në rastin e “Vjedhjes së arit “është edhe një zyrtar policor me gradën toger nga Stacioni Policor i Pejës. Me këtë rast Prokurori ka urdhëruar arrestimin e tij dhe është ngritur kallëzim penal për veprën penale “Shpërdorim i detyrës zyrtare apo autorizimit”. Rasti i është dërguar prokurorit kompetent për veprime të mëtejshme.





Gjatë vitit 2012 Inspektorati Policor i Kosovës ka ndërmarrë dhe rekomanduar një total prej 90 masash dhe rekomandimesh të cilat kanë ardhur si kërkesa dhe nevoja gjatë zhvillimit të hetimeve, prej të cilave kanë qenë 18 arrestime, 66 rekomandime për suspendime dhe 6 rekomandime për transfer ( *shih tabelën nr. 9*).

Tabela. 9

MASA DHE REKOMANDIME TE SHQIPTUARA NGA IPK-ja													
Masat dhe Rekomandimet	Janar	Shkurt	Mars	Priill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
Zyrtarë policorë të arrestuar nga IPK-ja	0	1	0	1	1	3	2	3	4	1	1	1	18
Zyrtarë policorë të suspenduar nga IPK-ja	0	2	2	7	13	3	7	15	3	7	4	3	66
Zyrtarë policor të transferuar	0	0	1	0	0	1	0	1	1	0	2	0	6
<b>Totali i masave dhe rekomandimeve nga Dep. I Hetimeve</b>	<b>0</b>	<b>3</b>	<b>3</b>	<b>8</b>	<b>14</b>	<b>7</b>	<b>9</b>	<b>19</b>	<b>8</b>	<b>8</b>	<b>7</b>	<b>4</b>	<b>90</b>

Bazuar në legjislacionin në fuqi që rregullon fushëveprimtarinë e agjencisë, IPK-ja ka të drejtë të kryejë hetimin e integritetit të punonjësve të Policisë së Kosovës. Ky aktivitet kryhet përmes Departamentit të Testit të Integritetit, departament ky i ngritur në kuadër të strukturës së organizimit të brendshëm të IPK-së.

Objekt i veprimtarisë së Departamentit të Testit të Integritetit është “hetimi i integritetit i cili ka për qëllim të zhvillojë kapacitetin pro-aktiv në ruajtjen e etikës dhe integritetit në kuadër të standardeve të larta profesionale brenda Policisë së Kosovës, duke kontribuar në përpjekjet mbi kontrollin e korrupsionit, duke rritur cilësinë e shërbimit dhe rritjen e besimit të publikut ndaj Policisë”.

Në fillim të periudhës së dytë gjashtëmujore të vitit 2012, DTI-ja ka filluar të merret me trajtimin e lëndëve apo rasteve të para të pranuar nga sektorë tjerë, për të shqyrtuar kështu mundësinë e organizimit dhe zbatimit të testeve të integritetit ndaj punonjësve policorë.

Në këtë drejtim, DTI-ja ka trajtuar gjashtë (6) raste, ku për dy (2) prej tyre ka zbatuar testet e integritetit bazuar në informacionin mbi aktivitetet kriminale dhe për të cilat janë nxjerrë raportet e detajuara përfundimtare pas-operative me rezultatet e operacioneve. Për një (1) rast ka përfunduar hetimet, duke njoftuar Prokurorinë kompetente me raport njoftues për shkak të mungesës së dyshimeve për përfshirje në veprimtari penale të punonjësit policor të dyshuar, kurse për tri (3) raste, për të cilat ekziston dyshimi se mund të ketë përfshirje të punonjësve policorë në veprimtari penale, është vlerësuar si e nevojshme që në të ardhmen të organizohen testimet e integritetit.





## VI. AKTIVITETET KRYESORE TË IPK-së NË ZBATIMIN E KOMPETENCAVE INSPEKTUESE GJATË VITIT 2012

Një ndër funksionet bazë të Inspektoratit Policor të Kosovës është edhe zhvillimi i inspektimeve ndaj Policisë së Republikës së Kosovës, raportimi mbi punën dhe efikasitetin në arritjen e qëllimeve të menaxhmentit të saj dhe dhënia e rekomandimeve lidhur me efikasitetin, efektivitetin dhe pajtueshmërinë e punës policore me ligjet në fuqi, identifikimin dhe parandalimin e çfarëdo devijimi nga aktet ligjore dhe procedurat me të cilat funksionon Policia e Kosovës.

Përmes procesit të inspektimit, IPK-ja bënë vlerësimin e mënyrës së kryerjes së detyrave në Policinë e Kosovës, duke:

- **Përcaktuar nëse ligjet, rregulloret përkatëse dhe parimet e procedurat e Policisë së Kosovës zbatohen ashtu si duhet dhe janë të përshtatshme për të arritur qëllimet e saj;**
- **Përcaktuar nëse burimet e Policisë shfrytëzohen në mënyrë efektive dhe efikase dhe se janë të përshtatshme për të arritur qëllimet dhe objektivat e saj organizative;**
- **Parandaluar shkeljet që mund të kryhen gjatë veprimtarisë së Policisë së Kosovës; Identifikuar mangësitë dhe duke rekomanduar masa ligjore e organizative për funksionimin më të mirë të Policisë së Kosovës.**

Në drejtim të përmbushjes së obligimeve që dalin nga legjislacioni për të ushtruar mbikëqyrje të përhershme mbi punën e organizatës policore, Departamenti i Inspektimeve ka bërë përgatitjet për funksionalizimin e një numri inspektimesh në Policinë e Kosovës duke përpiluar Planin Vjetor të Inspektimeve të Rregullta 2012 ku janë paraparë 4 inspektime të rregullta.

Identifikimi i fushave policore ku u zhvilluan këto Inspektime është e bazuar në rëndësinë e programeve/fushave policore, ndjeshmërinë e kompleksitetin e saj, riskun e identifikuar, frekuencën e inspektimit dhe nevojën e organizimit në kohën kur institucionet relevante kanë shtuar përpjekjet për ngritjen e efikasitetit, efektivitetit dhe përgjegjshmërisë në kryerjen e detyrave.

Në vazhden e aktiviteteve të saj gjatë vitit 2012, Departamenti i Inspektimeve ka realizuar 8 inspektime në Policinë e Kosovës nga të cilat 5 kanë qenë inspektime të rregullta ndërsa 3 inspektime të jashtëzakonshme.

Në vazhdim do të paraqesim numrin, fushën e inspektuar dhe llojin e inspektimit për secilin inspektim. Nga tetë inspektime shkurtimisht do të prezantojmë edhe përmbajtjen dhe disa te gjetura nga katër inspektime.




1. Inspektimet e rregullta ishin:

- 1) Inspektim mbi kryerjen e detyrave policore në planifikimin, furnizimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e flotës operative të Policisë së Kosovës.
- 2) Identifikimi dhe vlerësimi i procedurave të arrestimit/ndalimit në Policinë e Kosovës.
- 3) Vlerësimi i procedurave të hetimit të rasteve të aksidenteve të trafikut në Policinë e Kosovës
- 4) Vlerësimi i shpërndarjes së personelit në Policinë e Kosovës
- 5) Menaxhimi i Policisë Kufitare.

2. Inspektimet e jashtëzakonshme ishin:

- 1) Vlerësimi i kryerjes së detyrave policore më 14 janar të vitit 2012 nga Policia e Kosovës, gjatë protestave të organizuara nga lëvizja “Vetëvendosje”
- 2) Vlerësimi i performancës policore gjatë ndërrimit të natës mes të premtës dhe të shtunës, në Stacionet Policore dhe NJTR.
- 3) Ekzekutimi i urdhëresave dhe letër-rreshtimeve nga Policia e Kosovës - Stacioni Policor Gjakovë.





## SHEMBUJ RASTI NGA DISA INSPEKTIME TE ZHVILLUARA NGA IPK-ja PËR VITIN 2012

### 1) Vlerësimi i kryerjes së detyrave policore më 14 janar të vitit 2012 nga Policia e Kosovës, gjatë protestave të organizuara nga lëvizja “Vetëvendosje”

Më 14 janar të vitit 2012, në afërsi të dy pikave të kalimit kufitar me Serbinë, në “Merdarë” dhe në “Dhe të Bardhë”, pasi ishte organizuar një protestë nga pjesëtarë të “Lëvizjes Vetëvendosje” në dy lokalitete të ndara, ku pas disa orësh të shprehjes së pakënaqësisë së pjesëmarrësve, kishte pasuar reagim policor. Për dhënien e një vlerësimi të paanshëm dhe të drejtë është ndier e nevojshme kycja e Inspektoratit Policor të Kosovës në vlerësimin e mënyrës së menaxhimit të situatës nga struktura policore gjatë operacionit të zhvilluar.



Pas trajtimit të bërë për vlerësimin e rrjedhës së operacioneve policore në dy lokacionet e ndara, është vërejtur se ato janë menaxhuar mirë, me nevojën për përmirësim të vazhdueshëm të performancës sidomos në metodat e arrestimit. IPK-ja ka vërejtur se ende ekzistojnë dobësi në pajisjen e zyrtarëve policorë me pajisje të nevojshme për ballafaqim me turmat dhe se ka nevojë për trajnime të vazhdueshme lidhur me metodat e arrestimit.



Ne kemi evidentuar 4 raste të shkeljeve disiplinore dhe penale nga disa policë gjatë këtij operacioni të cilat i ka adresuar në prokurori dhe PK për hetime të brendshme disiplinore.

Duhet te përmendet fakti se Inspektorati Policor i Kosovës nuk ka pranuar asnjë ankesë nga qytetarët që kanë marrë pjesë në këtë protestë, përveç rastit të një gazetari i cili kishte qenë i sulmuar fizikisht nga një zyrtar policor.

**Përmbledhje e rekomandimeve:** Rekomandimet kryesore gjatë këtij inspektimi ishin që Policia e Kosovës në të ardhmen të ngritë dhe përmirësoj akoma nivelin e performancës në menaxhimin e turmave në aspektin taktik-operacional përmes organizimit të trajnimeve në fushat e menaxhimit të turmave duke kryer trajnime të ndryshme të përbashkëta në mes të njësisive të ndryshme operative në mënyrë që ata në të ardhmen ti bashkërendojnë sa më mirë veprimet e tyre në terren për të kryer detyrat e tyre varësisht nga përgjegjësitë e tyre qofshin ato planifikuese, operative apo logjistike.



## 2) Inspektim mbi kryerjen e detyrave policore në planifikimin, furnizimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e Flotës Operative të Policisë së Kosovës.

Për kryerjen me sukses të detyrave policore të përcaktuara me ligj në mënyrë sa më efektive, PK-së i duhet që të ketë në dispozicion numrin e mjaftueshëm të automjeteve si dhe që ato automjete të jenë në gjendje të mirë për të operuar. Për gjendjen e automjeteve të PK-së përkujdeset Flota Operative si dhe një numër i konsiderueshëm i kompanive private të cilat janë të kontraktuara nga policia për servisimin dhe riparimin e automjeteve të tyre.



Gjatë inspektimit, IPK-ja ka konstatuar se gjendja teknike e automjeteve të PK-së ishte deri diku e kënaqshme, pasi që 84% e tyre ishin në shfrytëzim efektiv nga personeli i PK-së. Shqetësues ishte fakti i vjetërsimit të automjeteve të PK-së, ku 35% e automjeteve ishin më të vjetra se shtatë vjet. Kjo gjendje do të rëndohet edhe më tepër vitin 2013 pasi që pritet se kjo shifër të jetë 50% më të vjetra se shtatë vjet. Për mirëmbajtjen e automjeteve (servisim dhe riparim) përveç flotës operative PK-ja ka të kontraktuara edhe disa kompani private të licencuara për servisimin dhe riparimin e automjeteve.

Mirëpo, udhëzimi administrativ dhe PSO-të nuk i precizojnë kompetencat se kush mund të autorizoj riparimin e automjeteve në serviset private, gjithashtu nuk e precizojnë se për cilat lloje të riparimeve duhet të dërgohen në këto servise private.

IPK-ja ka konstatuar edhe vështirësitë me të cilat ballafaqohet Flota Operative e PK-së e që ishin: buxheti tejet i limituar dhe i pa mjaftueshëm, procedurat e gjata të prokurimit për blerjen e pjesëve rezervë, vonesat në realizimin e kontratave nga operatorët ekonomik për furnizimin me pjesë, mungesa e hapësirave të mjaftueshme në depot për deponimin apo sistematizimin e pjesëve rezervë.





Inspektorati Policor i Kosovës pasi ka analizuar këto të gjetura të këtij inspektimi konstaton se kjo gjendje është nën nivelin e kërkuar dhe ndikon negativisht në imazhin e Policisë së Kosovës dhe Institucioneve të Republikës së Kosovës.

**Përmbledhje e rekomandimeve:** IPK rekomandon Drejtorit të Policisë së Kosovës që, duke qenë se menaxhimi i Flotës Operative është një ndër fushat më të kushtueshme për Policinë e Kosovës dhe si e tillë kërkon një profesionalizëm të lartë për menaxhim e saj, urgjentisht të reagoj duke bërë një planifikim të mirëfilltë në menaxhimin e kësaj flote dhe të vlerësoj llogaritë financiare të këtij menaxhimi, duke identifikuar edhe metoda tjera alternative të menaxhimit jashtë Policisë së Kosovës.

### 3) Identifikimi dhe vlerësimi i procedurave të arrestimit/ndalimit në Policinë e Kosovës



Bazuar në autorizimet dhe funksionet që dalin nga Ligji për Inspektoratin Policor të Kosovës, Departamenti i Inspektimeve ka ndërmarrë inspektim në fushën e arrestim/ndalimit.

Për shkak të ndjeshmërisë që ka arrestimi, pasi bëhet fjalë për kufizimin e lirisë së lëvizjes së personit, Inspektorati Policor i Kosovës ka bërë inspektimin e kësaj fushe me qëllim që të identifikoj dhe vlerësojë çështjet procedurale të arrestim-ndalimit.

Inspektorati Policor i Kosovës pas analizimit të të gjitha çështjeve që kanë dalë pas inspektimit ka ardhur në përfundim se formularët e aplikueshëm që shërbejnë për rastet e arrestim/ndalimit, janë në përputhje me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës. Ndërsa, sa i përket zbatimit të këtyre procedurave IPK-ja ka evidentuar mangësi dhe lëshime të cilat kanë ardhur si rezultat i mbikëqyrjes jo të duhur dhe neglizhencës.

**Përmbledhje e rekomandimeve:** Duke u bazuar në rezultatet dhe të gjeturat gjatë inspektimit, Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon personelin e nivelit mbikëqyrës brenda strukturës të PK-së, që të ngritin nivelin e performancës së tyre duke aplikuar mbikëqyrje të vazhdueshme tek stafi përgjegjës drejt përmirësimit të performancës policore në zbatimin e proceduarve të arrestim/ndalimit, si dhe të organizoj trajnime adekuate për shtimin e njohurive në lëmin e procedurës së arrestit/ndalimit policor.



#### 4) Vlerësimi i procedurave të hetimit të rasteve të aksidenteve të trafikut në Policinë e Kosovës

Bazuar në autorizimet dhe funksionet që dalin nga Ligji për Inspektoratin Policor të Kosovës, Departamenti i Inspektimeve ka ndërmarrë një inspektim në Policinë e Kosovës gjegjësisht Njësitë e Trafikut Rajonal, në fushën e hetimit të rasteve së aksidenteve në trafikun rrugor.

IPK është fokusuar që të bëjë inspektimin e kësaj fushe me qëllim, që të identifikoj dhe vlerësoj çështjet e zbatimit të procedurave të hetimit të aksidenteve të trafikut dhe në respektimin e këtyre rregullave në praktikë.

Në bazë të dispozitave ligjore në fuqi si dhe parimeve e procedurave të PK-së, përgjegjësia për hetimin e rasteve të aksidenteve të komunikacionit i takojnë Njësitë të Trafikut Rajonal të PK-së që janë të ndara në gjashtë regjione kryesore.

IPK-ja ka bërë identifikimin dhe vlerësimin e përputhshmërisë së procedurave të hetimit të aksidenteve të trafikut dhe rregullativën ligjore në fuqi, ka gjetur se Njësitë e Trafikut Rajonal edhe pse tanimë kanë një rregullativë ligjore, Ligjin Për Komunikacion, akoma nuk kanë PSO në pajtim me këtë ligj dhe ndryshimet infrastrukturore në Kosovë.

Njësitë e Trafikut Rajonal ende punojnë me Doracakun Operacional për Trafik, i cili duhet të rishikohet dhe të plotësohet me ndryshimet e reja në Republikën e Kosovës. Procedura Standarde e Operimit (PSO) do të duhej të përshkruante dhe përcaktonte në mënyrë unike standardet e punës së NJTR-së duke përfshirë: autorizimet, fushëveprimet, detyrat dhe kufizimet e autorizimeve, organizimin si dhe kompetencat e NJTR-ve.

**Përmbledhje e rekomandimeve:** Bazuar në rezultatet e gjetura gjatë procesit të inspektimit, IPK-ja i rekomandon Departamentit të Komunikacionit Rrugor-DPP Prishtinë që sa më shpejt të nxjerrin një PSO të azhurnuar për trafik. Niveli drejtues i Njësitë të Trafikut Rajonal, përmes kontrollit të brendshëm, të evitoj parregullsitë në zbatimin e standardeve të punës dhe procedurave hetimore në trafik. Gjithashtu, IPK rekomandon, që të mbahen trajnime të brendshme lidhur me kompletimin e dosjeve të rastit si dhe në plotësimin e formularëve të nevojshëm për hetimin e aksidenteve të trafikut rrugor.



## VII. SHËRBIMET ADMINISTRATIVE DHE MBËSHTETËSE

Departamenti i Administratës dhe Shërbimeve Mbështetëse (DASHM) i IPK-së kryen të gjitha punët administrative dhe ka rol mbështetës në mbarëvajtjen e punëve të agjencisë. Ky departament sipas strukturës organizative të IPK-së në vete përmban tre sektorë me gjithsej 14 (katërmëdhjetë) zyrtarë, dhe atë:

- Sektori i Burimeve,
- Sektori për Buxhet dhe Financa si dhe
- Sektori i Prokurimit.

Departamenti për Administratë dhe Shërbime Mbështetëse përmes personelit të saj përkujdeset që t'u ofroj departamenteve operative mbështetje materiale, logjistike, teknike si dhe të gjitha shërbimet tjera administrative në mënyrë që të rritet efikasiteti dhe të realizohen në përpikëri planet e hartuara të departamenteve operative.

Fushat në të cilat DASHM përkujdeset të ju ofroj shërbime departamenteve operative janë:

- buxheti dhe financat,
- personeli,
- prokurimi,
- teknologjia informative,
- transporti dhe
- logjistika

Nga plani zhvillimor strategjik i IPK-së 2012-2015 rrjedhin disa obligime të cilat duhet të përmbushen nga Departamenti për administratë dhe shërbime mbështetëse. Obligime të cilat janë:

- Themelimi i një plani vjetor të detyrueshëm të trajnimit për të gjithë anëtarët e stafit të IPK-së,
- Të nxirret një propozim i ndryshimit të buxhetit për të rritur burimet hetimore inspektuese për inspektor dhe hetues shtesë deri me plotësimin e strukturës organizative,
- Identifikimi dhe marrja e burimeve të nevojshme për të zbatuar qëllimet dhe objektivat e IPK-së 2012 deri më 2015,
- Zbatimi i teknologjisë për të rritur shërbimin e konsumatorëve për klientët e jashtëm dhe të brendshëm.

Obligimet e lartë cekura të cilat rrjedhin nga Planit Zhvillimor Strategjik i IPK-së 2012-2015, gjatë vitit 2012 janë plotësuar plotësisht në bazë të planit të veprimit për realizimin e kësaj strategjie.





Pra, gjatë vitit 2012 janë realizuar 12 trajnime për personelin operativ (inspektor dhe hetues), trajnime këto të cilat kanë qenë nga fusha e hetimeve dhe trajnimi për ricertifikim, si dhe 7 trajnime për personelin mbështetës (shih tabelën nr. 10).

Tabela. 10

TRAJNIMET E PERSONELIT TË IPK-se				
Nr	Lloji i trajnimit	Organizata	Numri i pjesëmarrësve	Orët
1	Kursi i Avancuar për Mbledhjen e Dëshmimeve	ICITAP	26	40
2	Kursi Bazik për Auditimin e Performancës së Zbatimit të Ligjit	ICITAP	19	8
3	Kursi për Vëzhgim dhe Informator Konfidencial	ICITAP	19	40
4	Shkolla për Personel Policor dhe Komandim	ICITAP	2	480
5	Menaxhimi i dokumenteve zyrtar, protokollimi, arkivimi dhe procedurat për qasje ne dok. Zyrtare	FLSA	1	16
6	Kursi i Hetimit të Përfshirjes së Zyrtarit Policor ne Gjuajtje me Armë	ICITAP	22	80
7	Trajnimi ne Procedurat e Prokurimit dhe Tenderëve	OSBE	2	88
8	Kursi i Ricertifikimit/ Armë	AKSP	40	21
9	Taktikat Mbrojtëse	AKSP	28	35
10	Trajnimi ne Dizajnimin e Kurikulave- Faza e parë	OSBE	2	120
11	NCIS/ Seminari i Asistencës Teknike-Kosovë	ICITAP	6	88
12	Analizat e Avancuara të Larjes së Parave	ICITAP	3	24
13	Menaxhimi i dokumenteve zyrtar,protokollim,arkivim dhe procedurat për qasje ne dok. Zyrtare	FLSA	1	16
14	Klasifikimi i vendeve. Rregullorja nr. 05/2012	IKAP	1	16
15	Moduli i blerjeve/ Zyrtari i pranimit te mallit	MEF	1	3
16	Menaxhimi dhe Zhvillimi i Burimeve Njerëzore	OSCE	1	40
17	LSHCRK Rregulloret nr.04/2010, 05/2010, 06/2010	IKAP	1	16
18	Kursi i Auditimit te Performances	ICITAP	1	8
19	Buxheti, decentralizimi i shpenzimeve dhe menaxhimi i financave publike	FLSA	1	24

Siç shihet nga tabela e më sipërme numri më i madh i trajnimeve është zhvilluar nga ekspert të ndryshëm amerikan, të rekrutuar nga ICITAP, nga agjencionet më të njohura dhe më të mira botërore të zbatimit të ligjit si; Departamenti i Policisë së Los Angjellostit LAPD, Shërbimi i Marinës Amerikane për Hetimin e Krimit NCIS, Universiteti NORTHWESTERN, Prokuror nga



Departamenti i Drejtësisë Amerikane etj, të cilat kanë ofruar programe trajnimi bazike dhe të avancuara nga fusha të ndryshme të zbatimit të ligjit.

Nga tabela e më sipërme shihet edhe llojllojshmëria e trajnimeve të cilat kanë qenë shumë përmbajtësore dhe specifike për punën dhe detyrat dhe përgjegjësitë që ka personeli operativ i IPK-së ( hetuesit dhe inspektorët) për të arritur rezultate sa më efektive në zbatimin e mandateve të tyre ligjore në ballafaqim me elementet kriminale dhe destruktive të cilat mund të infektojnë shërbimin e policisë ndaj qytetarëve të vendit.

Stafi operativ i IPK-së ka kryer edhe kurset e ricertifikimit në përdorimin e forcës si pjesë e autorizimeve të reja policore që ka marr IPK-ja me ligjin e ri të IPK-së duke trajnuar stafin e saj në përdorimin e taktikave mbrojtëse dhe përdorimin e armëve zjarrtare.



Trajnimi i zyrtarëve të IPK-së me arme zjarri

Inspektorati Policor i Kosovës gjatë vitit 2012 ka pasur një personel prej 58 pjesëtar të cilët kanë qenë: meshkuj 45, ndërsa femra 13, pra IPK-ja në kuadër të saj ka një përqindje mjaft të lartë edhe të gjinisë femërore, në IPK janë edhe dy serb dhe 1 boshnjak të cilët përfaqësojnë edhe aspektin etnik të shumë llojshmërisë në IPK( *shih tabelën nr. 11*).

Tabela. 11

Përbërja etnike dhe gjinore e personelit të IPK-së	
<b>Përbërja gjinore</b>	
Meshkuj	45
Femra	13
58	
<b>Përbërja etnike</b>	
Shqiptarë	55
Serb	2
Boshnjak	1
58	



Ceremonia e betimit te zyrtarëve te IPK-së

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve në IPK si dhe të përmbushjes së qëllimeve dhe objektivave të IPK-së, në muajin shkurt të vitit 2012 është nënshkruar një marrëveshje në mes të Ministrit të MPB-së, Kryeshefit të IPK-së dhe Drejtorit të Përgjithshëm të PK-së, marrëveshje kjo e cila mundëson transferimin e 15 zyrtarëve policor me përvojë nga PK-ja në IPK të cilët pas ceremonisë së betimit zyrtar menjëherë kanë filluar punën në IPK. Gjithashtu gjatë këtij viti janë organizuar



dhe realizuar edhe disa konkurse për pranimin e punonjësve të rinjë në IPK .

Buxheti i IPK-së për vitin 2012 ka qenë i pamjaftueshëm për përmbushjen e nevojave të domosdoshme të IPK-së. Mirëpo, gjendja në aspektin buxhetor për IPK-në është rregulluar dukshëm përmes procesit të rishikimit buxhetor, konkretisht përmes Ligjit me Nr.04/L-128, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit me Nr 04-L-079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012, buxheti i IPK-së ka pësuar një ngritje në kategorinë ekonomike të Paga dhe Mëditjeve si dhe në kategorinë ekonomike të Investimeve Kapitale.

Kjo ngritje e buxhetit për IPK-në ka qenë esenciale për mbarëvajtje të punëve si dhe arritje të objektivave të parapara për realizim gjatë viti 2012, e në veçanti ngritja e shumës buxhetore në Kategorinë Ekonomike të Investimeve Kapitale kë bërë që punimet në ndërtesën e re e IPK-së, gjatë vitit 2012 të përfundojnë në masën prej 75%. Pas ngritjes së buxhetit si dhe pas transferit të një pjese të buxhetit nga një kategori ekonomike në tjetrën, paraqitja tabelore e buxhetit të IPK-së për vitin 2012 ka marr tjetër formë( *shih tabelën nr. 12*).

**Tabela. 12**

Buxheti i IPK-së	2012- fillestar		2012- i rishikuar		Diferenca
Kategoria Ekonomike	Shuma	Përqindja	Shuma	Përqindja	
Paga dhe Mëditje	295,899.00	38.41	325.899.00	32.58	+30.000 euro
Mallra dhe Shërbime	263,328.00	34.18	253.328.00	25.32	-10.000 euro
Shpenzime Komunale	11,000.00	1.42	21.000.00	2.09	+10.000 euro
Projekte Kapitale	200,000.00	25.96	400.000.00	39.99	+200.000 euro
<b>Totali</b>	<b>770,227.00</b>	<b>100</b>	<b>1,000,227.00</b>	<b>100</b>	<b>+230.000 euro</b>

Në tabelën dhe grafikun e radhës do të prezantohen: Buxheti, Alokimi i mjeteve buxhetore, Shpenzimet Buxhetore, Mbetja e mjeteve buxhetore nga Buxheti total si dhe Mbetja e mjeteve buxhetore nga Alokimi total( *shih tabelën nr. 13*).

**Tabela. 13**

Kategoria Ekonomike	Buxheti	Alokimi	Shpenzimi	Mbetja nga Buxheti	Mbetja nga Alokimi
Paga dhe Mëditje	325.899.00	325,896.00	316,562.41	9,336.59	9,336.59
Mallra dhe Shërbime	253.328.00	243,364.00	173,654.29	79,673.71	69,709.71
Shpenzime Komunale	21.000.00	20,999.00	17,999.32	3,000.68	2,999.68
Projekte Kapitale	400.000.00	400,000.00	287,628.77	112,371.23	112,371.23
<b>Totali</b>	<b>1,000,227.00</b>	<b>990,259.00</b>	<b>795,844.79</b>	<b>204,382.21</b>	<b>194,417.21</b>



Objekti i ri i IPK-së, investim kapital i vitit 2012

## VIII. ZHVILLIMI I BASHKËPUNIMIT ME QYTETARËT, ORGANIZATAT VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE

Zhvillimi i marrëdhënieve me organizatat partnere dhe me publikun është i rëndësishëm thelbësor për IPK-në. Gjatë këtij viti, IPK-ja ka pasur një mori aktivitete në vazhden e përpjekjeve për të ndërtuar marrëdhënie të qëndrueshme me qytetarë dhe partnerë të ndryshëm, me organizata qeveritare e jo qeveritare dhe me media.

### a) Bashkëpunimi i drejtpërdrejt me qytetarët

Duke filluar me datën 17 maj Inspektorati Policor i Kosovës në vazhden e aktiviteteve të saj për sensibilizimin e opinionit publik lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e saj ka mbajtur disa ligjërata me studentet dhe profesorët e të Kolegjeve Universitare, ISPE, Iliria, Dardania dhe FAMA ku janë mbajtur ligjërata me temën “Inspektorati Policor I Kosovës, roli dhe rëndësia në sundimin e ligjit në Kosovë” .

Ligjërues në këto Ligjërata ka qenë zyrtar të lartë nga menaxhmenti i Inspektoratit Policor të Kosovës. Gjatë këtyre ligjëratave ka pasur një interesim të madh të studentëve dhe profesorëve



Pjesëmarrës gjatë kampanjës sensibilizuese të IPK-së në kolegjin ISPE



Pjesëmarrës gjatë kampanjës sensibilizuese të IPK-së në kolegjin Dardania

si dhe të mediave të shumta lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e Inspektoratit Policor të Kosovës. Interesimi është vërejtur në parashtrimin e shumë pyetjeve lidhur me brengat e qytetarëve për performancën e Policisë së Kosovës dhe masat e ndërmarra nga IPK-ja si mekanizëm i pavarur nga policia.

Këto aktivitete do të vazhdojnë edhe më tutje në universitetet dhe kolegjet tjera si përpjekje për të ngritur nivelin e bashkëpunimit të Inspektoratit Policor të Kosovës dhe qytetarëve të vendit që së bashku të kontribuojmë në forcimin e sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës.



## b) Bashkëpunimi me Institucionin e Avokatit të Popullit

Inspektorati Policor i Kosovës dhe Avokati i Popullit si dy institucione të pavarura, kanë një bashkëpunim të ngushtë në mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Republikën e Kosovës. Bashkëpunimi në mes dy institucioneve ka filluar nga takimi i përbashkët të Kryeshefit Ekzekutiv të IPK-së dhe Avokatit të Popullit, ku të dy krerët e këtyre institucioneve janë pajtuar në shkëmbimin e informacioneve me interes të përbashkët. Ky bashkëpunim është dëshmuar me pranimin e disa ankesave nga zyra e Avokatit të Popullit të cilat janë bërë nga qytetarët nëpërmes kësaj zyre për fillimin e procedurës, ku kanë pretenduar se u janë shkelur të drejtat dhe liritë e tyre nga ana e Policisë së Kosovës.



Institucioni i Avokatit të Popullit  
Institucija Ombudsmana  
Halk Avokati Enstititisi  
Themesqi Avokatesqi Insitucia  
Ombudsperson Institution

## c) Bashkëpunimi me media

Gjatë periudhës raportuese për punën dhe aktivitetet e IPK-së ka qenë një interesimi i madh si nga ana e komunitetit të gazetarëve të shoqërisë civile edhe nga ana e publikut, ku është demonstruar një gatishmëri e plotë për të bashkëpunuar ngushtë në rastet ku kanë qenë të përfshirë pjesëtarë të Policisë së Kosovës.

Bashkëpunimi me mediet është përqendruar në takimet me gazetarë për raste të ndryshme dhe të dhëna statistikore, konferenca dhe njoftime për shtyp dhe fushata promovuese.



Ministri i MPB-së, Kryeshefi i IPK-së dhe zyrtarë të lartë të Policisë së Kosovës në një konferencë të përbashkët për media.

Për iniciativat dhe aktivitetet e IPK-së ka pasur një interesim të madh, si nga gazetarët, ashtu edhe nga publiku, ku është demonstruar një gatishmëri për të bashkëpunuar ngushtë në luftën kundër fenomeneve negative si, korrupsioni dhe krimi i organizuar.

Inspektorati Policor i Kosovës në vazhdimësi i ka njoftuar mediet për punën dhe aktivitetet që janë zhvilluar përmes formave të ndryshme me qëllim që të tregoj transparencë dhe informim të duhur qytetarëve. Duke qenë i përkushtuar në ngritjen e transparencës në raport me qytetarët, IPK-ja ka realizuar disa paraqitje publike. Janë realizuar intervista me emisionin ('Drejtësia në Kosovë') dhe emisione ku kanë ofruar mundësi qytetarëve për t'u informuar me aktivitetet e IPK-së.

Intervistat me mediumet televizive, si RTK-në, Klan Kosova dhe RTV21, po ashtu janë realizuar me qëllimin që opinioni publik të njoftohet me fushatën senzibilizuese mbi punën e IPK-së.

Rol me rëndësi në njoftimin e publikut me punën e IPK-së ka luajtur edhe faqja zyrtare elektronike e cila ka qenë një dritare e hapur për të gjithë ata që kanë qenë të interesuar për aktivitetet tona dhe raportimet për raste të ndryshme.

**d) Bashkëpunimi me ARTC-në (Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim)**

IPK ka qenë pjesë e Kampanjës “**Drejtësia dhe Qytetarët**”, e cila kampanjë është zhvilluar dhe koordinuar nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC), Qendra për Ndihmë Juridike, Zhvillim Rajonal (CLARD), dhe “Sejdiu dhe Qerkinit, G.P.” me mbështetje nga Public International Law and Policy Group (PILPG).



**Drejtësia dhe qytetarët**  
**Pravda i ljudi**  
**Justice and the people**

Kjo kampanjë si qëllim primar ka pasur që ti ftoj të gjithë qytetarët të marrin pjesë në: Punëtoritë për Informim Publik lidhur me Mekanizmat e ankesave për sistemin e drejtësisë që janë në dispozicion për qytetarët. Punëtoritë janë mbajtur në të gjitha komunat e Kosovës, ku në disa prej tyre kanë prezantuar edhe përfaqësues të IPK-së, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen në Radio Televizionin e Kosovës (RTK) dhe Radio Televizionin 21 (RTV 21).

Në takimet e zhvilluara, qytetarët janë informuar për mekanizmat e ankesave në sistemin e drejtësisë për gjyqtarët, prokurorët, policinë, dhe avokatët.

Në këto punëtori kanë prezantuar përfaqësues nga kampanja Drejtësia dhe Qytetarët, Avokatët e viktimave, Këshillat Lokale për Siguri në Komunitet, Gjykata Komunale, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Inspektorati Policor i Kosovës, Oda e Avokatëve dhe Organizata Clard.

Në kuadër të qëllimit primar të Kampanjës “Drejtësia dhe Qytetarët”, qytetarët janë informuar lidhur me të drejtën e tyre që ju takon në bazë të ligjit dhe mundësit që atyre u ofrohen për të paraqitur ankesë qoftë duke qenë prezent personalisht në objektet e IPK-së, apo përmes mundësive për të paraqitur ankesë në mënyrë elektronike, lidhur me dyshimin që ata kanë ose shqetësimin e tyre se ndonjë pjesëtar i Policisë së Kosovës është involvuar në ndonjë vepër penale ose ka shkelur ndonjë të drejtë të qytetarëve gjatë kryerjes së detyrave policore dhe jashtë saj.

**e) Bashkëpunimi me Prokurorinë dhe Policinë**

Bashkëpunimi me Prokurorinë Publike është i paraparë edhe me legjislacionin në fuqi. Gjatë punës së përditshme, punonjësit e strukturës hetimore të agjencisë dhe menaxhmenti i saj kanë krijuar lidhje shumë të ngushta bashkëpunimi në drejtim të luftimit të korrupsionit në polici. Me kërkesën e menaxhmentit të IPK-së drejtuar Kryeprokurorit të Shtetit është caktuar një Prokuror i veçantë për të punuar me IPK-në.





Bashkëpunim i këtillë është krijuar edhe me Policinë e Kosovës. Bashkëpunimi është orientuar në dhënien e kontributit për ngritjen e performancës së dy agjencive dhe ofrimin e ndihmës teknike operative dhe mbështetëse, të paraparë edhe me legjislacionin në fuqi. Është e njohur se IPK-ja ka të drejtë të përdorë një numër burimesh të organizatës policore, deri në momentin kur agjencia krijon kushtet e mjaftueshme për punë.

Inspektorati Policor i Kosovës dhe Prokuroria e Shtetit të Republikës së Kosovës kanë krijuar raporte të partneritetit dhe bashkëpunimit në luftën e dukurive negative të cilat hasen në radhët e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, e në veçanti në luftimin e korrupsionit përmes, shkëmbimit të informacioneve lidhur me dyshimin e implikimit në veprimtari penale të zyrtarëve policor, bashkëpunimin në hetimin e rasteve që rezultojnë me veprime kriminale, dhënien e autorizimeve nga Prokuroria për ndërmarrjen e veprimeve të caktuara hetimore nga ana e IPK-së, ndihmë dhe asistencë gjatë procesit të hetimor si dhe ofrimin e këshillave të ndërsjella në zgjidhjen e problemeve të ndryshme që kanë të bëjnë me luftimin e dukurive negative në Policinë e Kosovës.

Si rezultat i këtij bashkëpunimi Prokuroria e Shtetit ka caktuar një Prokuror të Shtetit si këshilltar për hetuesit e Inspektoratit Policor të Kosovës me qëllim që ti ofrojë ndihmë ligjore për rastet penale të cilat janë duke u hetuar nga IPK-ja.

Po ashtu bashkëpunim të mirë IPK-ja ka edhe me shërbimet administrative të Prokurorive, ku ky shërbim konsiston në dhënien e informacioneve të sakta dhe të shpejta lidhur me rastet të cilat IPK-ja, përkatësisht Departamenti i Hetimeve i ka proceduar në Prokuroritë kompetente.

## f) Bashkëpunimi me SHKB-në

Bashkëpunimi me Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm të Shqipërisë (SHKB) ka qenë i një rëndësie të veçantë. Duke qenë agjenci partnere në luftimin e korrupsionit dhe keq menaxhimit policor, edhe këtë vit ka vazhduar bashkëpunimi reciprok në drejtim të shkëmbimit të përvojave.

Në SHKB është realizuar një vizitë pune në qershor, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga IPK-ja. Vizita është realizuar me qëllim të thellimit të bashkëpunimit si dhe shkëmbimin e përvojave të dy agjencive. Në këtë vizitë delegacionet janë pritur nga udhëheqësit më të lartë të Ministrisë së Rendit dhe SHKB-së.







### g) Bashkëpunimi me ICITAP-in

Marrëdhëniet me ICITAP-in janë të natyrës këshillëdhënëse dhe mbështetëse, nga të cilat IPK-ja ka dobi në aspektin këshillëdhënës, në ofrimin e trajnimeve dhe donacioneve. Kjo organizatë edhe këtë vit ka mbështetur agjencinë tonë në shumë fusha.

Në drejtim të ofrimit të mbështetjes në nxjerrjen e udhëzimeve administrative që burojnë nga Ligji për IPK-në, kontributi i kësaj organizate ka qenë prioritar dhe i pa zëvendësueshëm.

ICITAP-i ka ofruar për agjencinë tonë një numër trajnimesh të cilat kanë ngritur kapacitetet profesionale të punonjësve tanë duke ofruar programe dhe ekspert nga agjencionet më të mira në SHBA dhe në botë në fushën e zbatimit të ligjit. Trajnimet të cilat ka ofruar ICITAP për IPK-ne kanë qenë më së të nevojshme dhe të qëlluara për të arritur përmbushjen e misionit të IPK-së (*shih tab. 27*).

Me qëllim të identifikimit të nevojave për trajnime dhe për ngritjen profesionale për personelin e IPK-së, DASHM ka bashkëpunuar ngushtë me përfaqësuesin nga ICITAP-i në realizimin e projektit për hartimin e një pyetësoi elektronik. Përmes këtij pyetësoi do të kemi mundësin që t'i testojmë aftësitë tona profesionale si dhe në të njëjtën kohë do të kemi mundësin e identifikimit të nevojave për trajnime të mëtutjeshme në mënyrë që të fuqizohen kapacitetet profesionale në kuadër të IPK-së.

Po ashtu, ICITAP-i ka sponsoruar pjesëmarrjen e katër punonjësve të IPK-së në Shkollën Ndërkombëtare për Staf Policor dhe Komandë, në AKSP. Në këtë trajnim tre (3) mujor pjesëmarrës ishin edhe një numër punonjësish nga Policia e Kosovës, Policia e Shqipërisë, Policia e Malit të Zi, Policia e Maqedonisë, Policia e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe ajo e Kroacisë.

ICITAP ka treguar gatishmëri të plotë në mbështetjen e vazhdueshme për të dhënë këshillat e nevojshme përmes këshilltarëve të vet, të cilët kanë qenë të përkushtuar në ofrimin e praktikave të vendeve më të zhvilluara, të cilat kanë pasur suksese të dukshme në luftën kundër korrupsionit dhe keq menaxhimit policor.

Duke parë një gatishmëri për bashkëpunim nga ana e kësaj organizate, IPK-ja ka vendosur në njërin nga objektivat strategjike të saj edhe thellimin e bashkëpunimit të vazhdueshëm me këtë organizatë.





Personeli I IPK-së gjatë trajnimit nga ekspertë amerikan në ambientet e ICITAP-it

## h) Bashkëpunimi me EULEX-in

Misioni Evropian për Sundimin e Rendit dhe Ligjit – EULEX, ka luajtur një rol mjaft të rëndësishëm në IPK. Bashkëpunimi ka qenë i një niveli të lartë, ku vlerësohet shumë kontributi i tyre këshillëdhënës si në fushën e hetimeve po ashtu edhe në atë të inspektimeve. Një falënderim i madh u shkon edhe Prokurorëve të EULEX-it të cilët kanë ndihmuar në disa raste të veprave penale, dhe pa asnjë hezitim na kanë përkrahur IPK-në në çdo fazë të hetimeve.



Vizita e Shefit të EULEX-it Xavier Bout de Marnhac në IPK

Vlen të përmenden edhe vizita Shefit të Misionit EULEX, Xavier Bout de Marnhac në Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK) në kuadër të mandatit të misionit për mbështetje të institucioneve vendëse të sundimit të ligjit. Gjatë vizitës së tij, de Marnhac kishte përsëritur përkushtimin e EULEX-it për IPK-në, duke thënë: “Ishte me rëndësi që të vijë dhe të vizitojë IPK-në sepse paraqet institucion kyç për qytetarët e Kosovës. Ky është vendi ku shprehet besimi që ata e kanë për policinë. (...) Roli i IPK-së hyn në kuadër të shumë

standardeve të cilat institucionet për sundimin e ligjit në Kosovë duhet t'i përmbushin për të arritur deri te liberalizimi i vizave në një të ardhme të afërt".

Takimet e shumta që janë mbajtur edhe në mes të monitoruesve të këtij misioni dhe zyrtarëve të lartë të IPK-së, duke ofruar përvojat e tyre në çështjet me interes të dyanshëm, me qëllimin e vetëm për të arritur rezultate më të mira në luftë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. IPK ka çmuar punën e këtij misioni në përmirësimin e rendit dhe ligjit në Kosovë. Po ashtu, si pjesë e kontributit të këtij misioni gjatë vitit 2012, ka qenë edhe dhurimi i gjashtë veturave si donacion për Inspektoratin Policor të Kosovës.

Një prej mënyrave me të cilën EULEX-i ka mbështetur IPK-në ka qenë edhe përmes fushatës televizive për ngritje të profilit të IPK-së dhe të ilustrimit të rëndësisë që ka për popullin e Kosovës duke prodhuar një dokumentar dhe një reklamë televizive.

### **i) Bashkëpunimi me OSBE-në**

Marrëdhëniet e agjencisë me Misionin e OSBE-së në Kosovë janë marrëdhënie të ndërtuara nga viti 2006. Kjo organizatë, që nga kontributi në nxjerrjen e bazës ligjore dhe implementimin e Programit për ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore të IPK-së, gjatë tërë kohës ka vazhduar të mbështesë punën e agjencisë.



**Ceremonia përmbyllëse e punës se përbashkët IPK- OSBE ne ambientet e MPB-së**

Marrëdhëniet tona kanë qenë të natyrës këshillëdhënëse, nga të cilat IPK-ja ka pasur dobi si në aspektin këshillëdhënës, po ashtu edhe në përfitimin e trajnimeve dhe donacioneve.

Në vitin e kaluar kjo organizatë ka përmbyllur me sukses misionin e saj me IPK-ne duke konsideruar se IPK-ja tanimë është plotësisht operacionale.

Kjo nuk do të thotë se me këtë ka mbaruar edhe bashkëpunimi me këtë organizatë sepse IPK-ja do të vazhdoj edhe në të ardhmen të ketë bashkëpunim të ndërsjellë me këtë organizatë.



## IX. PËRFUNDIME

Në kuadër të implementimit të reformave institucionale MPB-ja përmes politikave të saj, gjatë vitit 2012, ka përkrahur shumë IPK-në duke krijuar mundësi për ngritje të mëtutjeshme të kapaciteteve njerëzore dhe financiare në arritjen e realizimit të misionit të saj në mënyrë sa më efektive. MPB-ja ka krijuar mundësi për rekrutim të vazhdueshëm të stafit të nevojshëm, për IPK-në, për të kryer detyrat dhe përgjegjësitë e saj dhe ka krijuar kushte më të mira për akomodim dhe punë.

Siç dihet roli i policisë është që të shërbej dhe mbrojë shoqërinë nga kriminaliteti, të mbroj pronën dhe jetën e qytetarëve të vendit, të ruaj rendin e përcaktuar juridik e kushtetues. Pra, policia ka mision fisnik, autorizime të mëdha dhe përgjegjësi të mëdha. Si çdo institucion tjetër që duhet të ketë mekanizmin e saj demokratik të kontrollit edhe Policia e Kosovës ka Inspektoratin Policor të Kosovës si mekanizëm i cili përkujdeset që policia të kryej misionin e saj me fisnikëri.

Siç pamë edhe nga ky raport, Inspektorati Policor i Kosovës, gjatë vitit 2012 përmes menaxhimit përmes objektivave ka arritur që me sukses të implementoj shumë qëllime strategjike të përcaktuara në Planin Zhvillimor Strategjik 2012-2015. IPK-ja përmes këtij plani synon të vendos dhe ruaj standardet më të larta profesionale në zbatimin e mandateve ligjore të IPK-së dhe të arrij që të përmbush qëllimet e saj strategjike duke u përkujdesur që policia të kryej misionin e saj me profesionalizëm.

Qëllimi kryesor dhe më i rëndësishëm strategjik të cilën IPK-ja i ka përcaktuar veti është që IPK do të jetë një lider i njohur në zbatimin e mandateve ligjore për të parandaluar keq-menaxhimin, korrupsionin dhe aktivitetet tjera kriminale brenda Policisë së Kosovës.

Këtë qëllim IPK-ja e ka arritur gjatë vitit 2012 duke vendosur dhe ruajtur standardet profesionale gjatë zbatimit të mandateve dhe duke hartuar dhe përcjellë planet mujore dhe vjetore për zbatueshmërinë e Mandateve Ligjore për secilin sektor, departament dhe program të veçantë, p.sh:

- Departamenti i Inspektimeve kishte planifikuar katër inspektime të rregullta në katër fusha të menaxhimit në PK-së dhe kishte realizuar tetë inspektime apo katër inspektime më shumë të cilat kishin dalë si nevojë e menjëhershme për shkak të disa rrethanave të jashtëzakonshme. Nga këto tetë inspektime, 3 ishin inspektime të jashtëzakonshme apo të pa planifikuara të cilat është dashur që të trajtohen me shpejtësi dhe seriozitet.
- Departamenti i Hetimeve konform kërkesave të reja ligjore kishte kryer planifikimet e duhura për menaxhimin e hetimit të rasteve duke zvogëluar kohën për zgjedhjen e rasteve me karakter kriminal duke bashkëpunuar ngushtë me partner të ndryshëm si Policia e Kosovës dhe prokuroria për të arritur që sa më shpejt shkelësit e ndryshëm të ligjit të dalin para drejtësisë dhe të marrin dënimet e merituar.



- Departamenti i Testit të Integritetit edhe pse si departament i ri dhe me koncept të ri të punës ka arritur ta sprovtoj veten përmes zbatimit të katër planeve operative për teste integriteti dhe disa rasteve tjera të provoj integritetin e disa zyrtarëve policor.
- Departamenti për menaxhimin e ankesave dhe analizimin e informatave ka arritur që të bëjë pranimin, analizimin dhe sistemimin e një numri të madh të ankesave dhe informatave dhe përcjelljen e tyre për në departamentet gjegjëse.
- Departamenti i Administratës ka bërë planifikimin dhe menaxhimin e një numri të madh të kërkesave logjistike, administrative dhe financiare në mbështetje të departamenteve operative të IPK-së.

Pretendimi që IPK-ja të jetë një lider i njohur në zbatimin e mandateve ligjore për të parandaluar keq-menaxhimin, korrupsionin dhe aktivitetet tjera kriminale brenda Policisë së Kosovës është argumentuar përmes ngritjes profesionale dhe shtimit të aktiviteteve planifikuese operative të përcjella me aktivitete konkrete.

IPK-ja edhe në të ardhmen do të përqendrohet për të siguruar shërbim të shkëlqyer për qytetarët, për aktorët-partnerët e saj të jashtëm dhe të brendshëm përmes një shërbimi ndaj qytetarëve i cili do të jetë – i kompletuar, korrekt, i kujdesshëm, i kryer me përkushtim, me mirësjellje dhe i qartë.

Përmes përpjekjeve efektive, gjatë komunikimit në terren, IPK-ja do të sigurojë qytetarëve dhe palëve të interesuara informacione relevante, në kohë dhe të azhurnuara. Ne do të sigurohemi që ankesat e qytetarëve, informacionet nga qendrat e thirrjes dhe stafi që është përgjegjës për menaxhimin e këtyre ankesave dhe informacioneve të jenë të pajisur në mënyrë optimale për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive në kërkesat e qytetarëve.

# SHKURTESAT

---

MPB	MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME;
IPK	INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS;
PK	POLICIA E KOSOVËS;
ICITAP	INTERNATIONAL CRIMINAL INVESTIGATIVE TRAINING ASSISTANCE PROGRAM
SHKB	SHËRBIMI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM
EULEX	MISIONI EVROPIAN PËR SUNDIMIN E LIGJIT NE KOSOVË
ARTC	QENDRA E TRAJNIMEVE DHE BURIMEVE PËR AVOKIM
AKSP	AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE
KEEP	KODI EVROPIANE I ETIKËS POLICORE
UE	UNIONI EVROPIAN
OSBE	ORGANIZATA PËR SIGURI DHE BASHKËPUNIM NË EVROPË
PSO	PROCEDURA STANDARDE TË OPERIMIT
DPP	DORACAKU I PARIMEVE DHE PROCEDURAVE TË POLICISË SË KOSOVËS
NJTR	NJËSIA E TRAFIKUT RAJONAL
NJHR	NJËSIA E HETIMEVE RAJONALE
NJHDPK	NJËSIA E HETIMEVE TË DREJTORISË SË POLICISË KUFITARE
DRP	DREJTORIA RAJONALE E POLICISË
DPP	DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË
DASHM	DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE





**Keni ankesë në lidhje  
me sjelljen e policisë?**

**THIRNI**

**INSPEKTORATIN POLICOR TË KOSOVËS**

**044 192 911**

Republika e Kosovës, Prishtinë

038 521 201 / 19 691;

038 521 149/19 702

[info.ipk@rks-gov.net](mailto:info.ipk@rks-gov.net)

[www.ipk.rks-gov.net](http://www.ipk.rks-gov.net)